



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 43/2023 (JR)
Datë 22.09.2023

Vendim nr. 12 (JR)
Datë 02.04.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 02.04.2024, ditën e martë, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj dhe avokatin e tij, z. Rezart

Kthupi, të cilët kërkuar lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Artur Ismajlukaj¹, me konstatimet se: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-u, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, fillimisht dërgoi raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit², të përpiluar pa përgjigjen e Shërbimit Informativ Shtetëror, duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës. Pas kërkesës së Komisionit nr. {***} prot., datë 10.05.2021, për përditësimin e raportit me shkresën e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe fillimin e procedurave të deklasifikimit të informacionit të dërguar në raportin e parë, AKSIK-u përcjell raportin e përditësuar³, sipas të cilit, nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, konstatimi fillestar për përshtatshmëri ndryshon në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Artur H. Ismajlukaj.

2.3. KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.01.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Artur Ismajlukaj, me funksion prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Tropojë, aktualisht prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Kukës”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Artur H. Ismajlukaj”, deklasifikuar plotësisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZh) me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2023.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.05.2021, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Artur H. Ismajlukaj”, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 11.06.2021, të KDZhsë.

të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, ka dërguar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 681, datë 07.07.2023, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi: *1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Artur Ismajlukaj. 2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent ILD, bazuar në nenin 103/ç, mbi “sjelljen e magjistratit jashtë ushtrimit të funksionit” të ligjit nr. 96/2016 për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit. [...]*
4. Procesi i rivlerësimit për subjektin Artur Ismajlukaj u krye mbi bazën e të tria kriterëve, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe vendimi i Komisionit është marrë pasi është arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme.
 - a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
 - b) Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, [...] lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
 - c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].

III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

5. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”), në mbështetje të rekomandimit për paraqitje ankimi⁵, të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), ka paraqitur ankim⁶ kundër vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit, duke kërkuar, në zbatim të nenit 66, pika 1,

⁴ Raporti nr. {***} prot., datë 18.03.2019, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.

⁵ Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 04.09.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë:
<https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/09/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-681-dat%C3%AB-7.7.2023-z.-Artur-Ismajlukaj.pdf>.

⁶ Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 19.09.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë:
<https://ikp.al/2023/09/19/ankim-kunder-vendimit-nr-681-date-7-7-2023-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-artur-ismajlukaj/>.

shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.

6. Në vlerësim të Komisioneres Publike, vendimi nr. 681, datë 07.07.2023, i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provat e administruara, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, arrin nivel të besueshëm për konfirmim në detyrë dhe çmon se ky vendim përmban shkaqe ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).
7. Mbështetur në jurisprudencën⁷ e Kolegjit, Komisionerja Publike sjell në vëmendje legjitimitetin e saj për të ushtruar ankim edhe ndaj vendimeve të Komisionit, në rastet për të cilat ky i fundit, në zbatim të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016⁸, ka evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016, i ndryshuar”) ose shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të magjistratit.
8. Në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së, shkeljet e evidentuara nga Komisioni, në rastin konkret, janë të tilla që nuk duhet të dalin jashtë juridiksionit të rivlerësimit kalimtar, por duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj. Sipas ankimit të Komisioneres Publike:

Kontrrolli i figurës

8.1. Përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe e interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Ndryshe nga arsyetimi i Komisionit në vendim, të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me personat e përfshirë në rrethanat faktike të dokumentuara së bashku me informacionin e disponuar nga organet ligjzbatuese, janë të tilla që ndikojnë në perceptimin publik të figura e magjistratit, sikurse dhe në besimin që duhet të ruajë sistemi i drejtësisë në tërësi, të dhëna, që në rastin konkret nuk mund të lihen jashtë vlerësimit tërësor të çështjes.

8.2. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, referuar rrethanave të rezultuara nga kontrrolli i figurës, në konsideratë dhe të përmbajtjes së *gjetjes*⁹ së paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, si dhe rekomandimit të ONM-së për paraqitje ankimi, sipas Komisioneres Publike rezulton i provuar fakti që subjekti i rivlerësimit më datë 8 janar 2017, ka kaluar kufirin shqiptar me një mjet me targë {***}, në pronësi të shtetasit K. J., person i përfshirë në krimin e organizuar. Për shkak të pozitës së subjektit të rivlerësimit dhe njohjeve të tij të ngushta në Tropojë, nuk duket bindës pretendimi i tij se nuk ka qenë në dijeni të

⁷ Shih vendimin (JR) nr. 2/2020, paragrafët 15.2 deri 15.7 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁸ Neni 59, pika 4 e ligjit 84/2016, parashikon: “Pavarësisht se subjekti të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim”.

⁹ Paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar me shkresën nr. {***} prot., datë 28.2.2023, “Gjetje”.

ngjarjeve që lidhen me këtë shtetas. Me këtë automjet, gjithashtu rezulton të kenë udhëtuar shtetas me të cilët subjekti i rivlerësimit ka lidhje familjare e shoqërore.

8.3. Në konsideratë të rekomandimit të ONM-së për paraqitje ankimi dhe të jurisprudencës së Kolegjit, vendimi i Komisionit duhet vlerësuar në tërësi, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, pasi rezultojnë disa rrethana të cilat, të analizuar së bashku e të para në raport me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje dhe qëndrim të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit të rivlerësimit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi. Rrethanat e dala nga kontrolli i figurës, ndonëse nuk çojnë në kualifikimin e subjektit si të papërshtatshëm në kuptim të këtij kriteri, të marra së bashku me rrethanat e tjera të trajtuara gjerësisht në ankim dhe në rekomandimin e ONM-së, tregojnë mjaftueshëm elemente që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, të vendosura në themel të mbrojtjes dhe forcimit të besimit të publikut, duke krijuar kështu premisat e duhura për një vlerësim tërësor sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Gjetje të tjera

8.4. Hetimi nga subjekti i rivlerësimit i çështjes në ngarkim të shtetasit D. M., në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies miqësore, në kufijtë e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, është një sjellje e cila më së paku ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element në tërësi me rastet e tjera të rezultuara, qoftë edhe në mungesë të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me njoftimin e drejtuesit të Prokurorisë apo prokurorin e çështjes, se kishte njohje me shtetasin D. M., mbeten në nivel deklarativ, pasi nga aktet nuk duket se subjekti i rivlerësimit ka sjellë ndonjë dokument provues.

8.5. Në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana dhe fakte që, për nga shpeshësia dhe kohëzgjatja e tyre, nuk mund të jenë rastësore, e që më së paku, tregojnë për një qëndrim neglizhent dhe jo të kujdesshëm të subjektit të rivlerësimit për ambientin dhe personat që e rrethojnë, që rezultojnë shkelës të ligjit dhe të dënuar, fakt që në sytë e një vëzhguesi të jashtëm, ngre pikëpyetje mbi integritetin dhe besimin e subjektit të rivlerësimit apo nevojës dhe interesave që e bashkojnë subjektin e rivlerësimit me këta individë, apo ndikimit të tyre në forma dhe mënyra të ndryshme. Për vetë statusin dhe funksionin që përfaqëson magjistrati, shmangia e kontakteve me persona me probleme me ligjin është një domosdoshmëri dhe nevojë, që shoqëria e gjerë duhet ta perceptojë dhe besojë si të tillë, qëllim kryesor i së cilës është pasja e besimit te sistemi i drejtësisë në tërësinë e tij. Në kushtet kur jo vetëm një, por disa kontakte të drejtpërdrejta apo të tërthorta dalin në pah, të analizuar së bashku e të parë në raport me njëri-tjetrin, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në ambientin që e rrethon, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit të rivlerësimit, si një funksionar i denjë i atij sistemi.

8.5.1. Në këto rrethana përfshihen si problematika jo vetëm udhëtimet e përsëritura me automjetet e personave me probleme me drejtësinë, por dhe pretendimet e subjektit të

rivlerësimit mbi normalitetin e kësaj situate, sipas të cilit: *për shkak të lidhjeve familjare dhe shoqërore, jetesës për një kohë të gjatë në të njëjtin komunitet, është më se e rëndomtë që të krijohen kontakte të rastësishme me persona të vlerësuar nga Komisioni si të papërshtatshëm.*

8.5.2. Me konsideratë qëndrimin e jurisprudencës së Kolegjit, Komisionerja Publike e gjen të padrejtë dhe jobindës konkluzionin e Komisionit, përfshirë këtu transferimin e çështjeve të rezultuara nga hetimi administrativ për inspektim pranë organit kompetent, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), duke i nxjerrë kështu jashtë juridiksionit të rivlerësimit kalimtar, për sa kohë rezultojnë rrethana që duhen vlerësuar në kuptim tërësor të procedurave të parashikuara nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Rrethanat e konstatuara do ta bënin të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit e, për rrjedhojë, në rastin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës lidhur me shoqërimin e tij me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të dënuar për vepra penale dhe, si pasojë, mbeten të provuara situata të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

8.6. Mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, Komisionerja Publike përmend rrethana, të cilat paraqesin elemente që mund të merren në konsideratë në gjykimin e kësaj çështjeje, në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të tilla si: (i) mospërputhja e deklarimeve lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 96,2 m², duke përfshirë në deklaratën e pasurisë *vetting* vlerën 1.000.000 lekë, dhuratë nga vjehri A. P.; (ii) kjo shumë është transferuar në të njëjtën ditë nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit tek ajo e shtetasit G. S. M., i cili rezultoi i rehabilituar pasi me vendimin nr. {***}, datë 31.03.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është deklaruar fajtor për veprat penale “Përvetësim të pasurisë shtetërore në bashkëpunim” dhe “Armëmbajtje pa leje”.

IV. Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit kundër ankimit

9. Më datë 20.09.2023, pasi është njohur me ankimin nr. {***} prot., datë 19.09.2023, të Komisioneres Publike, me të cilin është kërkuar shkarkimi nga detyra, subjekti i rivlerësimit ka depozituar më datë 25.09.2023, në Komision, “Parashtrime kundër ankimit, përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, duke e konsideruar ankimin rrjedhojë të një interpretimi të gabuar të provave e ligjit, e duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit, me pretendimet, në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.

9.1. Për përdorimin e automjetit në pronësi të shtetasit K. J., Komisionerja Publike nuk paraqet në asnjë rast kundërshtime në lidhje me gjetjet dhe përfundimet e arritura nga Komisioni, sikurse edhe nuk ngre asnjë pretendim në lidhje me shkelje apo cenim nga ana e subjektit të rivlerësimit të parimeve apo kriterëve të parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016.

9.2. Si shkak ligjor për kundërshtimin e vendimit të Komisionit, Komisionerja Publike përdor pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin e vlerësimit të përdorimit të automjetit në lidhje organike me të gjitha rrethanat e tjera të cituara në ankim, por pa përcaktuar se cilat ishin këto rrethana në raport apo edhe në kundërshtim me konstatimet dhe arsyetimin e Komisionit.

Komisionerja Publike nuk përcakton apo shprehet nëse ka apo jo kontakt të papërshtatshëm, qoftë edhe tërthor, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit K. J..

9.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin e Komisioneres Publike, e cila nuk konsideron bindës pretendimin e tij për mospasjen dijeni të ngjarjeve që lidhen me shtetasin J.. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit përmend disa rrethana që lidhen me vendin e lindjes, banimit, ushtrimin të aktivitetit kriminal, si dhe procedurave të ekstradimit të shtetasit K. J.. Në pjesën arsyetuese të ankimit, Komisionerja Publike nuk përcakton asnjë rrethanë të dalë nga kontrolli i figurës, që mund të vlerësohet veçmas apo bashkarisht me rrethana të tjera, si elemente apo sjellje që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore, rregullat e etikës apo sjelljes së anëtarëve të sistemit gjyqësor.

9.4. Nga leximi sistematik i nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, referuar nga Komisionerja Publike në ankim, do të duhej që pretendimet e saj të shtriheshin në të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimi i përgjithshëm i të cilave mund ta çonte Kolegjin në një mendim të ndryshëm nga ai i Komisionit e për pasojë, edhe në pranimin e ankimit të Komisioneres. Sjelljet e analizuar mund të klasifikohen vetëm në kriterin e kontrollit të figurës, e si të tilla duhet të vlerësohen brenda kriterëve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ashtu sikurse është bërë në vendimin e Komisionit.

9.5. Lidhur me veprimet hetimore të kryera në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore (në vijim “OPGj”), në procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit D. M., shkak i kundërshtimit të Komisioneres Publike nuk janë veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, por pjesëmarrja e tij në to, dhe qenia në konflikt interesi gjatë zhvillimit të këtyre hetimeve. Këndvështrimi i Komisioneres Publike për ndodhjen në kushtet e ndikimit dhe krijimit të perceptimit negativ të publikut, është krejtësisht empirik dhe në kundërshtim me përfundimet e arritura nga Komisioni. Kryerja e veprimeve hetimore, të cilat kanë passjellë dënimin e shtetasit D. M. jo vetëm nuk e cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, por përkundrazi e forcon atë.

9.6. Për sa kohë, në dosjen hetimore të procedimit penal nr. {***}, nuk ka asnjë provë apo *indicie*, që të jenë kryer veprime hetimore të paplota, që kanë favorizuar të pandehurin apo kanë prodhuar një vendim gjyqësor të deformuar në favor të tij, dhe për sa kohë vendimi gjyqësor ka prodhuar një dënim që nuk është ankimuar nga palët ndërgjyqëse, nuk mund të arrihet në përfundimin se veprimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë të ndikuara nga marrëdhëniet shoqërore e për pasojë të kenë cenuar besimin e publikut.

9.7. Në lidhje me shpeshësinë dhe kohëzgjatjen e kontakteve dhe pasojat që ato sjellin, subjekti i rivlerësimit pretendon se në tërësinë e tyre, kontaktet janë sporadike dhe shtrihen në një hark kohor prej afro 5 vitesh e, si të tilla, nuk mund të provojnë një skemë sjelljeje dhe as një qëndrim të vazhdueshëm të subjektit të rivlerësimit me persona të papërshtatshëm. Për shkak të rrethanave, këto kontakte janë rastësore dhe vlerësuar në tërësinë e tyre nuk mund të passjellin cenim të besimit të publikut në atë shkallë sa të çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa lidhur me qëndrimin subjektiv të subjektit të rivlerësimit ndaj kësaj sjelljeje, gjetjet dhe faktet i përkasin vetëm periudhës së ushtrimit të detyrës në rrethin Tropojë, ndërkohë që pas transferimit nga ky rreth, ndaj subjektit të rivlerësimit nuk gjendet asnjë e dhënë për kontakte të tilla. Këto dy elemente (shpeshësia dhe kohëzgjatja, si dhe qëndrimi

subjektiv), të marra dhe vlerësuar së bashku, provojnë se subjekti i rivlerësimit qoftë edhe subjektivisht ka kuptuar dhe vlerësuar drejt qëndrimin dhe mënyrën e veprimit që ai duhet të ketë në raport me marrëdhëniet shoqërore, me qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

9.8. Komisionerja Publike nuk ngre në asnjë rast pretendim lidhur me analizën dhe arsyetimin e Komisionit për secilin nga raportet, ngjarjet dhe gjetjet e listuara në vendim, por ngre pretendime për qëndrimin e Komisionit në raport me analizën dhe vlerësimin tërësor të tyre, duke mbështetur këtë pretendim në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dispozitë që kërkon një vlerësim tërësor të të tria kriterëve të parashikuara në pikën 1 të saj. Analiza në tërësi e fakteve dhe gjetjeve për të arritur në përfundimin e kushteve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 do të ishte, sipas subjektit të rivlerësimit, një zbatim i sertë i ligjit, pa analizuar rrethanat konkrete në të cilat faktet dhe gjetjet kanë ndodhur.

9.9. Legjislatori, në ligjin nr. 96/2016, ka parashikuar rastet kur veprime të caktuara përbëjnë shkelje disiplinore. Nga leximi sistematik i ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, rezulton se ka disa shkallë vlerësimi për kontaktet e papërshtatshme dhe jo çdo kontakt i papërshtatshëm është detyrimisht një shkak për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit e gjen të drejtë vendimin e Komisionit i cili i ka adresuar veprimet e tij në raport me kontaktet e papërshtatshme si veprime që hyjnë në sferën e zbatimit të nenit 103 të ligjit nr. 96/2016.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 10.** Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisionerja Publike të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

- 11.** Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh¹⁰ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰ Institucioni i Komisionerëve Publikë është njoftuar për vendimin e arsyetuar të Komisionit më datë 04.09.2023, sipas “Lajmërimarrjes” dhe ka depozituar ankimin më datë 19.09.2023.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Institucioni i Komisionerit Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit për subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
13. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, bazuar në nenin 20, pika 5/1 e rregullores së Kolegjit “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, janë ftuar palët pjesëmarrëse në këtë proces, Komisionerja Publike dhe subjekti i rivlerësimit që të depozitojnë parashtrimet e tyre me shkrim, së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe akte t’u komunikohen përkatësisht palëve në proces, për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, para seancës gjyqësore publike, për efekt të një ekonomie gjyqësore dhe të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor. Palëve pjesëmarrëse në proces u janë vënë në dispozicion parashtrimet me shkrim, të dërguara respektivisht përpara seancës gjyqësore të datës 29.02.2024, si dhe denoncimet¹¹ nga publiku të depozituara në Kolegj, adresuar subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.
14. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 29.02.2024, pasi dëgjoji parashtrimet e Komisioneres Publike dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë në cilësinë e provave, aktet¹² e sjella nga subjekti i rivlerësimit. Sa u përket denoncimeve të depozituara, pasi dëgjoji palët në proces, trupi gjykues, duke mos i gjetur ato në kushtet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos vijojë me kryerjen e hetimit të mëtejshëm.
15. Në seancën gjyqësore publike të datës 25.03.2024, me bisedimet përfundimtare, Komisionerja Publike, bazuar në pikat 3 dhe 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të

¹¹ Denoncimet nga publike: (i) denoncim nr. {***} prot., datë 06.02.2018 i shtetasit R. D.; (ii) denoncim i shtetasit E. Ç., përcjellë nga Institucioni i Komisionerëve Publikë me shkresën nr. {***} prot., datë 21.09.2023, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.09.2023; (iii) denoncim nr. {***} prot., datë 13.03.2024, i shtetasit A. E., depozituar gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj.

¹² Aktet e administruara në cilësinë e provës: (i) kërkesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Tiranë, nr. {***} prot., datë 12.02.2024; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 16.02.2024, me lëndë “Kthim përgjigje” e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile; (iii) certifikatë personale e z. K. Xh. J., lëshuar nga Njësia Administrative Berat, datë 15.02.2024; (iv) certifikatë familjare e familjes me kryefamiljar Xh. J., lëshuar nga Njësia Administrative Thumanë, datë 15.02.2024 (përbërja familjare e vitit 1998); (v) kërkesë drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Tropojë; (vi) shkresë nr. {***} prot., datë 15.02.2024, e Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Tropojë; (vii) kërkesë nr. {***} prot., datë 14.02.2024, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë; (viii) shkresë nr. {***} prot., datë 15.02.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin.

Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj, ndërsa subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

16. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), analizoi problematikat e ngritura nëpërmjet shkaqeve të ankimit, të cilat Komisionerja Publike kërkoi të vlerësohen në kuadër të vlerësimit tërësor të parashikuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe të arrihej në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, të parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

B/1 Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

17. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se në raportin nr. {***} prot., datë 20.05.2021, AKSIK-u informon se në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, dyshohet përfshirje në veprime korruptive e subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në vitet 2014 – 2016, dyshime për veprimtari të kundërligjshme dhe për kontakte të papërshtatshme. Në vlerësim të të dhënave nga autoritetet verifikuese, AKSIK-u arsyeton të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme, në formën e kontaktit/kontakteve të papërshtatshme, si dhe në veprimtari korruptive, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.
18. Komisioni, ashtu siç shprehet në vendimin objekt shqyrtimi¹³, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të AKSIK-ut, ashtu sikurse të gjitha provat dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
19. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj ka plotësuar saktë deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka arritur nivel të besueshëm në këtë kriter, sipas parashikimit të shkronjës “b”, pika 1 e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga vlerësimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, të të gjitha provave dhe shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, nuk u provua kontakti i papërshtatshëm. Në kushtet kur, nga një hetim i thellë dhe i gjithanshëm, nuk rezultoi ndonjë e dhënë për kontakt të papërshtatshëm të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, informacionet e marra nga institucionet ligjzbatuese janë verifikuar nga Komisioni dhe të dhënat e rezultuara nga hetimi u trajtuan në “Gjetje të tjera” të vendimin e tij.

¹³ Shih paragrafët 23 dhe 88 të vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

20. Komisionerja Publike, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit, referuar rrethanave të rezultuara nga kontrolli i figurës, në konsideratë dhe të përmbajtjes së gjetjes së paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, si dhe rekomandimit të ONM-së për paraqitje ankimi, vendos në vëmendje të Kolegjit faktin se rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit më datë 8 janar 2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar me një mjet me targë {***}, në pronësi të shtetasit K. J., person i përfshirë në krimin e organizuar. Për shkak të pozitës së subjektit të rivlerësimit dhe njohjeve të tij të ngushta në Tropojë, nuk duket bindës pretendimi i tij se nuk ka qenë në dijeni të ngjarjeve që lidhen me këtë shtetas. Me këtë automjet, gjithashtu rezulton të kenë udhëtuar persona me të cilët subjekti i rivlerësimit ka lidhje familjare e shoqërore.
21. Lidhur me këtë çështje, Komisioni, në vendim, nën dritën e rrethanave të parashikuara në nenin 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (a) nuk u provua asnjë e dhënë apo indicie për ekzistencën, qoftë edhe vetëm të një informacioni, kontakt, fotografim, bisedë telefonike apo e dhënë e treguar nga një dëshmitar, e subjektit të rivlerësimit me shtetasin K. J.; (b) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo ndonjë nga personat e lidhur të kishte ndonjë komunikim jorastësor me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo persona të lidhur me të, të kenë përfituar dhe as të kenë shkëmbyer ndonjë të mirë materiale të çfarëdo lloji me shtetasin K. J. apo me persona të tjerë të konsideruar si kontakt të papërshtatshëm në kuptim të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016; (ç) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar apo të ketë bërë takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, Komisioni ka çmuar se nuk disponohen elemente të mjaftueshme provueshmërie të situatave faktike të parashikuara në pikën 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, rrethana këto që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me standardet e kontrollit të figurës.
22. Trupi gjykues, në analizë të shkakut ankimor të ngritur nga Komisionerja Publike, konstaton se aktet në dosjen gjyqësore paraqesin këtë situatë faktike.
- 22.1. Në Komision, gjatë hetimit administrativ, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, është paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, shkresa nr. {***} prot., datë 28.2.2023, me objekt “Gjetje”.
- 22.2. Rrethanat konkrete të bëra prezent në gjetje, tregojnë se:
- (a) Nga baza e të dhënave të sistemit TIMS, subjekti i rivlerësimit më datë 8 janar 2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar në pikën kufitare Qafë Morinë, me automjetin me targë {***}, në pronësi të K. J. dhe përdorues A. T..
- (b) K. J. është shpallur fajtor më 3 janar 2016 nga Gjykata e Rimit, Itali, për 5 (pesë) akuza për shitje të lëndëve narkotike, si vepër e vazhdueshme, si dhe për 1 (një) akuzë për armëmbajtje pa leje, vepra këto të kryera në zonat e Bellaria Igea Marina dhe rrethinat e Rimit, gjatë periudhës shkurt - maj 2013, dhe u dënua me katër vjet e dy muaj burgim dhe një gjobë prej 26.000 eurosh. Vendimi mori formë të prerë dhe detyrues më 8 nëntor 2016. Ky shtetas është ekstraduar në Itali me kërkesë të autoriteteve italiane.
- (c) Veprat penale janë kryer në periudhën 2013-2014, pesë prej të cilave kanë të bëjnë me shitjen e narkotikëve, vepër e vazhdueshme ose në bashkëpunim. Prodhimi, shitja dhe trafikimi i narkotikëve janë vepra penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal, e që

përfshihen në listën e veprave penale të nenit 3, pika 1 e ligjit 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, të cilit i referohet neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 për të përcaktuar kategorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”.

22.3. Për qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, vëzhguesi ndërkombëtar referon se është e rëndësishme të sqarohen më tej marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit me shtetasin K. J., për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë kontakt mes tyre dhe në këtë rast, arsyet e mosdeklarimit të kontakteve të tilla nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës. Situata në fjalë, sipas tij, duhet të merret në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes, pasi mund të cenojë besimin e publikut në gjyqësor.

22.4. Me konsideratë të dhënat në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe konstatimet e AKSIK-ut, Komisioni ka zhvilluar një hetim të gjithanshëm për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë kontakt mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të përfshirë në krimin e organizuar, K. J..

22.5. Për këtë arsye, Komisioni vijoi hetimet duke u kërkuar informacion shoqërive të telekomunikacionit “ONE Albania” ShA dhe “Vodafone Albania” ShA, mbi kontratat e lidhura, si dhe të gjitha thirrjet hyrëse/dalëse, mesazhet e shkëmbyera, të numrave të telefonit të përdorur për periudhën 2014 – 2017, për këta shtetas. Shoqëria “One Albania”, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.04.2023, informon se sistemi nuk gjeneron informacionin për periudhën e kërkuar pasi kanë kaluar më tepër se dy vite, dhe sipas nenit 101 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe administrojnë të dhënat për pajtimtarët e tyre për një afat 2-vjeçar.

22.6. Sa i përket situatës së automjetit me targë {***}, i markës “Dodge”, modeli “Nitro”, në pronësi të shtetasit K. J., Komisioni, për arsye hetimi, iu drejtua Komisarariatit të Policisë Tropojë dhe atij të Kukësit, me kërkesën për informacion nëse ky automjet ishte sekuestruar, konfiskuar apo bllokuar. Referuar përgjigjes së këtyre institucioneve, nuk rezultoi një informacion i tillë. Ndërsa nga kërkesa drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, lidhur me sekuestrimin, konfiskimin apo bllokimin e automjetit në pronësi të shtetasit K. J., kjo e fundit përcjell shkresën e Komisarariatit të Policisë Vlorë nr. {***} prot., datë 19.05.2023, në të cilën thuhet se automjeti me targë {***}, aktualisht mban targën {***} dhe është në pronësi të shtetasit E. B.. I njëjti informacion përcillet edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2023, pas informacionit të marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

22.7. Nga të dhënat e sistemit të hyrje-daljeve në Republikën e Shqipërisë (TIMS), përcjellë në Komision nga Drejtoria e Policisë së Shtetit me shkresën nr. {***} prot., datë 25.03.2021, trupi gjykues konstaton se më datë 8 janar 2017, ora 11:13, subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë përmes pikës kufitare Qafë Morinë, me automjetin me targë {***}, së bashku me shtetasit Y. H. V. dhe E. S. H., nën drejtimin e këtij të fundit. Në datën 05.01.2017, po me këtë automjet, rezultojnë të kenë udhëtuar shtetasit A., N. dhe M. I., ndërsa më datë 09.01.2017, shtetasi A. K., me të cilët subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrëdhënie familjare dhe miqësore.

22.8. Lidhur me marrëdhënien me shtetasin K. J., si dhe qëllimin e përdorimit të automjetit të tij, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk e njeh këtë shtetas, nuk ka marrëdhënie të asnjë lloji me të, as kontakte të drejtpërdrejta apo të tërthorta, madje ishte hera e parë që dëgjonte emrin e tij e, si rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi të ketë dijeni që ky shtetas ka qenë i dënuar. Nga provat e administruara në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk provohet që ndërmjet tij dhe këtij shtetasi të ketë pasur njohje apo kontakte. Lëvizja e rastësishme me automjetin në pronësi të tij, nuk mund të interpretohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Për të përforcuar argumentin e tij, subjekti i rivlerësimit ka përmendur disa aspekte të përdorimit të automjetit, të tilla si: (i) ka udhëtuar me automjetin me targë {***} vetëm më datë 08.01.2017; (ii) nuk është poseduesi i këtij automjeti; (iii) nuk është personi që ka marrë fillimisht automjetin nga vendndodhja e tij fillestare; (iv) subjekti i rivlerësimit ka qenë vetëm në cilësinë e pasagjerit, çka provon pretendimin e tij për mospërdorimin e drejtpërdrejtë të mjetit e, për pasojë, mospasjen e kontakteve me shtetasin në fjalë.

22.9. Pavarësisht arsytimit të Komisionit në vendim, se në datën 08.01.2017, kur subjekti ka udhëtuar me këtë automjet si pasagjer, shtetasi K. J. vuante dënimin e tij në Itali, i ekstraduar në muajin shtator 2015, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi reale të kishte ndonjë kontakt me të, apo pretendimit të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet në Kolegj se nuk provohet që ky shtetas nga momenti i ekstradimit deri në datën e përdorimit të automjetit nga subjekti, të jetë futur apo të ketë qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga analizimi i të dhënave të sistemit TIMS, të administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjyqës konstaton se ky person ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë më datë 11.09.2015 nga aeroporti i Rinasit, ka hyrë më datë 30.10.2016 në portin e Durrësit, si dhe ka dalë përsëri më datë 25.01.2017 po nga porti i Durrësit. Megjithatë, ndonëse sipas këtyre të dhënave shtetasi K. J. rezulton të ketë qenë në Shqipëri në atë periudhë, në asnjë rast nuk u provua të ketë pasur kontakt mes tyre, sipas parashikimeve të nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për ta konsideruar kontakt të papërshtatshëm, me detyrimin për deklarimin në deklaratën e kontrollit të figurës.

22.10. Pamundësinë e kontaktit mes tyre, sipas parashkrimeve të subjektit të rivlerësimit në Kolegj, e provon edhe shkresa nr. {***} prot., datë 15.02.2024, e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, sipas së cilës në asnjë rast shtetasi K. J. nuk ka udhëtuar nëpërmjet pikës së kalimit kufitar në afërsi të Bashkisë Tropojë apo Qarkut Kukës, njësi administrative në të cilën ushtronte detyrën në periudhën objekt shqyrtimi subjekti i rivlerësimit.

22.11. Komisionerja Publike, në ankim, shprehet se për shkak të pozitës së subjektit të rivlerësimit, kontakteve dhe njohjeve të tij të ngushta në Tropojë, nuk duket bindës pretendimi i tij se nuk ka qenë në dijeni të ngjarjeve që lidhen me shtetasin J.. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet në Kolegj, e ka kundërshtuar këtë pretendim të Komisioneres Publike me argumentin se shtetasi K. J. nuk është i lindur, i rritur dhe as nuk rezulton të ketë banuar në rrethinat apo qytetin Tropojë e, për pasojë, nuk ka asnjë indicie që subjekti i rivlerësimit të kishte mundësi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për të pasur dijeni për ngjarje që lidhen me të, pavarësisht pozitës së tij, kontakteve apo njohjeve të tij të ngushta në Tropojë. Këtë fakt, sipas

tij, e provojnë dhe përgjigjet e institucioneve, të administruara në cilësinë e provës¹⁴ nga trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm më datë 29.02.2024, që tregojnë se K. J. është banues në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe nuk ka ndryshuar ndonjëherë vendqëndrimin apo vendbanimin e tij.

22.12. Nga ana tjetër, subjekti parashtron se aktiviteti kriminal i K. J. është zhvilluar në shtetin italian, fakt që provohet edhe nga dënimi i marrë nga një gjykatë italiane, ndërsa procedura e ekstradimit është realizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, fakt që përjashton prezumimin e çdo mundësie për marrjen dijeni nga ana e subjektit për aktivitetin kriminal të shtetasit J.. Nga hetimi i Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme¹⁵, në lidhje me procedurat e ekstradimit të shtetasit K. J. në shtetin italian, ka informuar se ky institucion ka mbajtur korrespondencë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe gjykatën e këtij rrethi, të cilat kanë ndjekur procedurat për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” dhe ekstradimin e këtij shtetasi në Itali.

22.13. Lidhur me marrëdhënien me shtetasin Y. V. dhe qëllimin e udhëtimit me të, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ka lëvizur me këtë automjet pasi e ka pasur në përdorim Y. V., i cili në atë kohë ka qenë i punësuar në Komisaratin e Policisë Tropojë, me detyrë Shef Seksioni i Krimeve të Rënda dhe me të cilin ka pasur marrëdhënie pune. Ndërsa, sa i përket qëllimit të udhëtimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se më datë 05.01.2017, ka udhëtuar në drejtim të rrethit Has për një rast vdekjeje, së bashku me shtetasit Y. V., A. I. (xhaxhai i subjektit të rivlerësimit), N. dhe M. I. (kushërinj të tij). Për shkak të kushteve klimaterike, rënies së borës, sipas subjektit, kanë qenë të detyruar të lëviznin me këtë automjet pasi ishte fuoristradë, si dhe kanë ndjekur linjën rrugore në pikën e kalimit kufitar Qafë Morinë, kanë hyrë në Kosovë për të shkuar në rrethin Has dhe kanë kaluar në pikën e kalimit kufitar Qafë Prush. Kalimi nëpërmjet Kosovës është bërë për faktin se rruga që të lidh direkt me rrethin Has ka qenë e bllokuar nga bora, i njëjti itinerar është ndjekur edhe në kthim. Në lidhje me udhëtimin në drejtim të Kosovës më datë 08.01.2017, subjekti i rivlerësimit sqaron se kanë shkuar për një drekë me shtetasit E. H., A. K. dhe Y. V. në fshatin Potok që ndodhet rreth 30 kilometra nga qyteti i Bajram Currit.

22.14. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit gjithashtu kundërshton si të pambështetur në prova konstatimin e Komisionit se ai duhet të ishte në dijeni të faktit që automjeti ishte në pronësi të një personi të përfshirë në veprimtari kriminale, si dhe të ekstradimit të tij në Itali si fakt të njohur publikisht¹⁶. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka asnjë provë që tregon se në vitin 2015, ai kishte njohje me shtetasin K. J., që të mund të mbante në kujtesë informacione publike në lidhje me veprimtarinë kriminale të tij e aq më tepër të ekzekutimit të një procedure ekstradimi, të ndjekur nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit paraqet: (i) deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 03.05.2023, të z. Y. V.; (ii) deklaratën noteriale

¹⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.02.2024, e Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Tropojë, sipas së cilës shtetasi K. J. nuk ka qenë asnjëherë banor i Njësisë Administrative Bajram Curri, Bashkia Tropojë; b Shkresë nr. {***} prot., datë 16.02.2024 e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me të cilën përcillet certifikatë personale e shtetasit K. J., si dhe certifikatë familjare e vitit 1998.

¹⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 25.4.2023.

¹⁶ Nga një verifikim në burime të hapura, rezulton se informacioni për ekstradimin e shtetasit K. J., dënuar për trafik lëndësh narkotike, është bërë publik në median online që në datën 12.9.2015, me artikull: “Ekstradohen drejt Italisë dy shqiptarë, ishin në kërkim ndërkombëtar”.

nr. {***} rep./kol., datë 03.05.2023, të z. E. K.; si dhe (iii) vërtetimin e Komisarariatit të Policisë Tropojë, me të cilin vërtetohet se z. Y. V. ka qenë i punësuar pranë këtij Komisaritati për periudhën 23.12.2016 - 01.03.2017, në pozicionin Shef i Seksionit të Krimeve të Rënda. Dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përmbajnë informacionet e mëposhtme.

22.14.1. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 03.05.2023, Y. V. deklaroi se automjetin me targë {***}, e ka pasur në përdorim për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Këtë automjet, ai deklaroi se e ka marrë nga djali i dajës E. K., por nuk e njeh pronarin e automjetit. Sipas deklaramentit të z. V., shtetasi Artur Ismajlukaj nuk ka pasur asnjë lidhje me këtë automjet, lehtësisht e provuar, pasi ashtu siç rezultoi nga të dhënat e TIMS-it, deklaruesi (Y. V.) ka hyrë vetëm në Shqipëri (Tropojë) nga pika e kalimit kufitar Qafë Morinë më datë 04.01.2017 dhe, pasi ka qëndruar disa ditë, është kthyer në Tiranë ku edhe banonte në atë kohë. Më datë 05.01.2017, ai deklaroi se së bashku me Artur Ismajlukajn dhe të afërm të tij kanë shkuar për një ngushëllim në rrethin e Hasit, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Qafë Morinë dhe Qafë Prush dhe janë kthyer sipas të njëjtit itinerar, si e vetmja rrugë e aksesueshme për shkak të motit. Gjithashtu, më datë 08.01.2017, ka shkuar në drejtim të Kosovës së bashku me shtetasin Artur Ismajlukaj, kolegë dhe disa persona me lidhje shoqërore pasi kanë qenë të ftuar për drekë nga shtetasi A. K. dhe më pas, janë kthyer në të njëjtin itinerar.

22.14.2. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 03.05.2023, z. E. K. deklaroi se automjetin me targë {***} ia kishte marrë shtetasit K. J. në janar 2017, me qëllim për ta përdorur disa ditë. Pasi në shtëpinë e tij në Mamurras kishte vajtur djali i hallës Y. V., i cili i kishte thënë se po shkonte në Tropojë ku dhe ishte i punësuar në Komisarariatit të Policisë, deklaruesi, z. K., i ka dhënë automjetin me targë {***}, të cilin e kishte të parkuar në oborrin e banesës. Automjeti ishte i tipit fuoristradë dhe duke qenë se ishte mot me dëborë në Tropojë, kushëriri Y. V. e kishte marrë, e kishte mbajtur disa ditë dhe më pas e kishte kthyer. Z. K., gjithashtu deklaroi se kushëriri i tij nuk ka asnjë lidhje dhe nuk e njeh shtetasin K. J..

22.14.3. Nga të dhënat e vërtetimit nr. {***} prot., datë 29.09.2022, të lëshuar nga Komisaritati i Policisë Tropojë, rezultoi se z. Y. V. ka pasur pozicion pune Shef i Seksionit të Krimeve të Rënda në këtë komisarariat, për periudhën 13.02.2008 – 24.02.2009 (*transferuar në Komisarariatit të Policisë nr. {***} Tiranë*) dhe, për periudhën 23.12.2016 – 01.03.2017, larguar me motivacionin: “Përjashtohet nga Policia e Shtetit”.

22.15. Në përgjigje të problematikës së ngritur nga Komisionerja Publike, në mbështetje të fakteve dhe rrethanave të trajtuara më sipër, trupi gjykues vlerëson se kalimi i kufirit shqiptar në pikën kufitare Qafë Morinë më datë 8 janar 2017, nga subjekti i rivlerësimit si pasagjer, me automjetin në pronësi të shtetasit K. J., person i përfshirë në krimin e organizuar, ndonëse nuk u provua asnjë kontakt i drejtpërdrejtë me të, si dhe nuk u provua njohja prej subjektit të rivlerësimit e aktivitetit të tij kriminal, dënimit në Itali apo procedurave të ekstradimit, edhe pse në automjet ndodheshin Y. V., në atë kohë me detyrë Shef i Seksionit të Krimeve të Rënda në Komisarariatit të Policisë Tropojë dhe E. H., Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nuk e përjashtoi subjektin e rivlerësimit nga përgjegjësia për pakujdesinë e treguar në udhëtimin me këtë automjet. Ndërsa, udhëtimi po me këtë automjet, edhe i personave të tjerë me lidhje shoqërore apo familjare me subjektin e rivlerësimit, përkatësisht më datat 05.01.2017 dhe 09.01.2017 nuk mund të afektojë integritetin dhe etikën profesionale të prokurorit.

23. Komisioni vlerësoi se faktet dhe rrethanat e rezultuara nga hetimi i çështjes janë të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e “cenimit të besimit të publikut” dhe ndaj tij duhet të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra. Komisioni çmon se kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit duhet parë dhe vlerësuar lidhur me kriteret e vlerësimit, në raport me gjetjet e rezultuara nga hetimi për kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe atë të aftësive profesionale. Shoqërimi i subjektit me persona me precedentë penalë, në kushtet kur nuk rezultuan problematika të tjera serioze në të tria kriteret, për Komisionin është i pamjaftueshëm për të aplikuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
24. Konkluzioni i Komisionit vjen si rezultat i arsytimit se sjellja e subjektit ndikon negativisht në figurën e magjistratit dhe cenon standardet e sjelljes së tij, etikën në punë dhe angazhimin ndaj vlerave. Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e duhur për të ruajtur të pastër në sytë e publikut figurën e magjistratit, mungesa e kujdesit të treguar dhe shoqërimi me persona të dënuar për vepra të ndryshme penale, është shqetësues dhe, sipas Komisionit, nuk duhet të mbetet pa u trajtuar. Me arsyetimin se ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga ana e subjektit, pasi me ligj janë kompetencë e një institucioni tjetër dhe, referuar në shkronjën “ç” të nenit 103 të ligjit nr. 96/2016¹⁷, i ndryshuar, konstatimet në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit, të parashikuara në nenin 103 e vijues të ligjit nr. 96/2016, i përcjell për kompetencë ILD-së për vlerësime të mëtejshme, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj.
25. Me konsideratë qëndrimin në jurisprudencën e Kolegjit, Komisionerja Publike e gjen të padrejtë dhe jobindës konkluzionin e Komisionit, përfshirë këtu transferimin e çështjeve të rezultuara nga hetimi administrativ për inspektim pranë organit kompetent ILD-së, duke i nxjerrë kështu jashtë juridiksionit të rivlerësimit kalimtar, për sa kohë rezultojnë rrethana që duhen vlerësuar në kuptim tërësor të procedurave të parashikuara nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Rrethanat e konstatuara do ta bënin të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit e, për rrjedhojë, në rastin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës lidhur me shoqërimin e tij me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të dënuar për vepra penale dhe për pasojë, mbeten të provuara situata të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.
26. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton sa më poshtë vijon.

26.1. Ashtu si përmendur më sipër në këtë vendim, Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, verifikoi informacionin e administruar nga organet ligjzbatuese. Kështu, nisur

¹⁷ Nga neni 103, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016 parashikohet si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit: “Shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënive të biznesit të papërshtatshme me këta persona”.

nga informacioni i administruar, rezultoi se Shërbimi Informativ Shtetëror kishte dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme informacionin nr. {***}, datë 15.11.2016, lidhur me “Fenomenin e kultivimit të cannabis sativa në vend”, ekstrakte të të cilit i janë përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. {***}, datë 30.11.2016. Për këtë çështje, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.03.2023, informon se nga verifikimet e kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezultojn që në emër të shtetasit Artur H. Ismajlukaj të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Komisioni kërkoi përsëri informacion për statusin aktual të çështjes, si dhe dosjen përkatëse nëse disponohet. Në përgjigjen nr. {***} prot., datë 02.06.2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bën me dije se informacioni i ShISH, përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresat e sipërcituara, është regjistruar në regjistrin e protokollit të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda, por nuk rezultojn që të jenë bërë shënime në regjistër në vijim, në lidhje me dorëzimin e kësaj shkrese dhe regjistrimin e ndonjë çështjeje penale.

26.2. Duke marrë shkas nga informacioni i institucioneve ligjzbatuese, si dhe të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, për një hetim të thellë e të gjithanshëm, Komisioni ka hetuar për disa persona, D. M., A. Z., P. Ç., A. e S. K. dhe A. O.¹⁸, me të cilët është pretenduar se subjekti i rivlerësimit shoqërohej dhe ka kaluar në pikat kufitare të Tropojës.

26.3. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 09.05.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm është emëruar Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe me dekretin nr. 8605, datë 20.06.2014, të Presidentit të Republikës emërohet prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Përveç disa muajve në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Vlorë dhe Kukës, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit dhe drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë¹⁹ deri në vitin 2021, që transferohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

26.4. Lidhur me shtetasin D. M., Komisionerja Publike, në ankim, shprehet se hetimi nga subjekti i rivlerësimit i çështjes në ngarkim të këtij shtetasi, në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies miqësore, në kufijtë e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, është një sjellje e cila më së paku ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element në tërësi me rastet e tjera të rezultuara, qoftë edhe në mungesë të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të

¹⁸ Subjekti i rivlerësimit nuk rezultojn të ketë udhëtuar me shtetasin A. O., për të cilin, referuar të dhënave të TIMS-it, nuk ka rezultuar të ketë ndonjë shkelje të ligjit. Referuar sistemit TIMS, A. O. ka udhëtuar me automjetin me targë {***}, gjatë periudhës 2013-2014, në pronësi të shtetasit D. M..

¹⁹ Nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorin Artur Ismajlukaj janë lëshuar këto akte: (i) urdhër nr. {***}, datë 30.10.2015, për komandimin prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nga data 02.11.2015 deri më datë 31.12.2015; (ii) urdhër nr. {***}, datë 14.03.2016, për komandimin drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; (iii) urdhër nr. {***}, datë 15.07.2016, për emërimin drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; (iv) vendim nr. {***}, datë 08.10.2017, për caktimin përkohësisht drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; (v) urdhër nr. {***}, datë 09.01.2018, për kthimin në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

rivlerësimit të rëndoje edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me njoftimin e drejtuesit të Prokurorisë apo prokurorin e çështjes se kishte njohje me z. D. M., mbeten në nivel deklarativ, pasi nga aktet, nuk duket se subjekti i rivlerësimit ka sjellë ndonjë dokument provues. Në analizë të këtij shkaku ankimor dhe konstatimeve të Komisioneres Publike në ankim, trupi gjykues konstaton:

26.4.1. Komisioni në vendim, lidhur me këtë rast, ka arsyetuar se: [...] *veprimet e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga vendimi i Gjykatës, provojnë se ky i fundit është sjellë në përputhje me etikën e oficerit të policisë gjyqësore, zbatimin korrekt të ligjit dhe shmangien e konfliktit të interesit.*

26.4.2. Nga të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar, përmes pikave kufitare të Qafë Morinës dhe të Qafë Prushit me: (i) automjetin me targë {***}²⁰, në pronësi të shtetases B. H., për periudhën 2013 - 2016, me përdorues B. I.²¹, vëllain e subjektit të rivlerësimit; (ii) automjetin me targë {***}, në pronësi të shtetasit E. H., me detyrë OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë. Me këto automjete, rezultojnë të ketë udhëtuar tri herë, përkatësisht më datë 06.07.2014 dhe 11.10.2015 me automjetin me targë {***}, e më datë 29.04.2016 me automjetin me targë {***}, edhe shtetasi D. M., por në data të ndryshme nga ato me të cilat ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit. Komisioni, në vendim, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk kishte udhëtime me këtë shtetas.

26.4.3. Komisioni ka administruar informacionin e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë²², dhe ka konstatuar që në ngarkim të shtetasit D. M. rezultojnë i regjistruar procedimi penal nr. {***} i vitit 2012, për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të Kodit Penal. Nga analizimi i kësaj dosjeje penale, trupi gjykues konstaton se:

26.4.4. Mbi bazën e materialit hetimor të përcjellë nga Komisariati i Policisë Tropojë, më 14.07.2012, rreth orës 00:30, në vendin e quajtur “{***}” në qytetin e Bajram Currit, përballë lokalit të shtetasit Q. A., janë përfshirë në një konflikt ky i fundit dhe shtetasi D. M. dhe, për pasojë, ka mbetur i plagosur me armë zjarri në këmbën e majtë Q. A..

26.4.5. Me urdhrin e datës 14.07.2012, “Për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}”, nga prokurori i çështjes A. Sh., urdhërohet regjistrimi i këtij procedimi penal për veprat penale të

²⁰ Ky automjet, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep./kol., datë 01.12.2015, i është shitur blerësit D. Gj. dhe, si pasojë e kontratave të shitblerjes të administruara në dosjen e mjetit, në vitet në vazhdim ka ndryshuar disa herë pronësi.

²¹ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 10.05.2023, B. H., babai i shtetases B. H., deklaroi se automjetin, vajza ia ka lënë në përdorim në periudha të ndryshme shtetasit B. I. me të cilin ka pasur marrëdhënie shoqërore, por pa bërë ndonjë kontratë huapërdorje.

²² Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2023, dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2023. Procedimi penal nr. {***} i vitit 2005, regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim mbetur në tentativë”, “Shkatërrim prone me eksploziv dy herë”, “Mbajtja pa leje e lëndëve plasëse”, parashikuar nga nenet 78-22, 152, 278/2 të Kodit Penal (dëmtim lokal i shtetasit D. M., dosje e pezulluar për mosnjohje të autorit të veprës penale) nuk është në ngarkim të shtetasit D. M., por ai rezultojnë person i dëmtuar.

“Plagosjes së rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 88/1 dhe 278/2 të Kodit Penal, ndaj shtetasit D. M. dhe për hetimin e procedimit penal ngarkohen oficerët e policisë gjyqësore P. S. dhe I. D.. Po në të njëjtën ditë, me urdhrin, datë 14.07.2012, “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, prokurori urdhëron oficerin e policisë gjyqësore Artur Ismajlukaj dhe I. D. që të kryejnë disa veprime hetimore. Veprimet hetimore deri më datë 15.07.2012, janë kryer nga OPGj-të e Komisarariatit të Policisë Tropojë, I. D., P. S. dhe A. A., ndërsa më pas aktet e veprimeve hetimore²³ për pyetjen e ripyetjen e dëshmitarëve, të dëmtuarit dhe të pandehurit, janë hartuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e OPGj-së në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

26.4.6. Me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë vendosi vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit dhe caktimin si masë sigurimi personal “Arrest në burg” për shtetasin D. M., i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 88/1 dhe 278/2 të Kodit Penal. Vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 22.08.2012.

26.4.7. Në relacionin e datës 16.10.2012, “Për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012”, subjekti i rivlerësimit, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, në bazë të nenit 327/1 të Kodit të Procedurës Penale, sugjeron që procedimi penal të dërgohet për gjykim për veprat penale të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të Kodit Penal.

26.4.8. Më datë 19.10.2012, prokurori i çështjes merr vendimin “Për dërgimin e çështjes në gjyq” për veprat penale të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të Kodit Penal.

26.4.9. Me vendimin nr. {***}, datë 4.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka vendosur: *Pushimin e çështjes penale për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal, për shkak se kjo vepër penale ishte amnistuar me ligjin 107/2012, datë 08.11.2012, shpallur me dekretin nr. 7824, datë 19.11.2012, të Presidentit të Republikës. Deklarimin fajtor të të pandehurit D. M., për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 10,5 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri dënohet përfundimisht me 7 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 14.12.2012.*

²³ (1) Procesverbal, datë 25.07.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, nga F. D.; (2) procesverbal, datë 26.07.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, nga R. A.; (3) procesverbal, datë 03.09.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personit ndaj të cilit zhvillohen hetime”; (4) procesverbal, datë 11.09.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, nga E. N.; (5) procesverbal, datë 18.09.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (Ripyetje)”, nga E. M.; (6) procesverbal, datë 19.09.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (Ripyetje)”, nga R. A.; (7) procesverbal, datë 26.09.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” (Ripyetje), nga Q. A.; (8) procesverbal, datë 03.10.2012, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, nga A. A.; (9) procesverbal, datë 19.10.2012, “I pyetjes së të pandehurit”; (10) procesverbal “Për njohjen e të pandehurit me aktet”; (11) procesverbal, datë 19.10.2012, “Mbi shpenzimet procedural për procedimin penal nr. {***} të vitit 2012”.

26.4.10. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 10.03.2023, ka informuar se shtetasi D. R. M. rezulton i rehabilituar, pasi me vendimin nr. {***}, datë 4.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”.

26.4.11. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shtetasin D. M. e njeh për shkak të lidhjes shoqërore të hershme me vëllain e tij B. M., me të cilin është njohur dhe shoqëruar që në kohën e shkollës së mesme. Veprimet hetimore në kuadër të procedimit penal nr. {***}, i janë deleguar nga prokurori i çështjes, njëherësh dhe drejtues i prokurorisë, të cilin e ka informuar verbalisht për ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit për shkak të njohjeve dhe marrëdhënieve shoqërore me të vëllain e të dyshuarit. Për shkak të rrethanave të ngjarjes, dyshimeve për përfshirjen e punonjësve të policisë dhe strukturës së cunuar të Prokurorisë, nga ana e prokurorit të çështjes, edhe me mirëkuptimin e subjektit të rivlerësimit, ishte vendosur që veprimet hetimore të kryheshin prej tij. Po kështu, subjekti i rivlerësimit sqaron se në atë kohë, ka qenë i vetmi OPGj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, e për të provuar këtë fakt, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka paraqitur shkresat e Prokurorisë së Përgjithshme²⁴ që provojnë se për vitet 2011 dhe 2012, kjo prokurori ka pasur në organikë vetëm një oficer të policisë gjyqësore dhe vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë²⁵, sipas të cilit për periudhën 01.09.2010 deri më 23.06.2014, ka ushtruar detyrën si oficer i policisë gjyqësore vetëm Artur H. Ismajlukaj. Në vijim, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se veprimet hetimore të kryera prej tij, çuan në përfundimin me sukses të çështjes penale dhe në dënimin e autorit të veprës penale me vendimin nr. {***}, datë 04.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Pavarësisht konfliktit të mundshëm të interesit, subjekti i rivlerësimit shprehet se veprimet e tij, të konfirmuara edhe nga vendimi i gjykatës, provojnë se ky i fundit është sjellë në përputhje me etikën e oficerit të policisë gjyqësore, zbatimin korrekt të ligjit dhe shmangien e konfliktit të interesit.

26.4.12. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit shprehet se shkak i kundërshtimit të vendimit të Komisionit nga Komisionerja Publike nuk janë veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit në çështjen konkrete, por pjesëmarrja e tij në to dhe qenia në konflikt interesi gjatë zhvillimit të tyre. Përfundimi i Komisioneres Publike se ndodhemi në kushtet e ndikimit dhe krijimit të perceptimit negativ të publikut, sipas subjektit të rivlerësimit, është krejtësisht empirik, pasi në vlerësimin e tij, kryerja e veprimeve hetimore sipas parashikimeve ligjore, të cilat kanë passjellë dënimin e shtetasit D. M. jo vetëm nuk e cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, por përkundrazi e forcon atë. Kryerja e veprimeve hetimore në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe etikën e oficerit të policisë gjyqësore, edhe në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesave, apo të marrëdhënieve miqësore me të pandehurin, sipas subjektit të rivlerësimit tregojnë integritetin e subjektit të rivlerësimit dhe vendosjen e ligjit dhe

²⁴ Shkresat nr. {***} prot., datë 22.02.2011 dhe nr. {***} prot., datë 08.02.2012, sipas të cilave, me urdhrat nr. {***}, datë 16.02.2011 dhe nr. {***}, datë 30.01.2012 të Prokurorit të Përgjithshëm, struktura organike e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për vitet 2011 dhe 2012, ka qenë: drejtues 1 (një); prokuror 1 (një); oficer të policisë gjyqësore 1 (një); kryesekretare 1 (një); sekretare 1 (një); shofer 2 (dy); pastruese 1 (një).

²⁵ Vërtetim nr. {***} prot., datë 19.04.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

detyrës përpara marrëdhënieve miqësore. Për sa kohë Komisionerja Publike nuk ka asnjë provë apo indicie që në dosjen hetimore të shtetasit D. M. ka veprime hetimore të paplota, që kanë favorizuar të pandehurin apo kanë prodhuar një vendim gjyqësor të deformuar në favor të të pandehurit, dhe për sa kohë vendimi gjyqësor ka prodhuar një dënim dhe nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse, sipas subjektit të rivlerësimit nuk mund të arrihet në përfundimin që veprimet hetimore të kryera prej tij kanë qenë të ndikuara nga marrëdhëniet shoqërore e, për pasojë, kanë cenuar besimin e publikut.

26.4.13. Në përfundim, për këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se kryerja e veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit D. M., ndërkohë që ka pasur marrëdhënie shoqërore me vëllain e tij B. M., dhe në kushtet kur mbetet në nivel deklarativ pretendimi i tij se ka njoftuar drejtuesin e prokurorisë për këtë njohje, pavarësisht fakteve të tilla, si: (i) veprimet janë kryer në ushtrim të detyrës si oficer i policisë gjyqësore, i ngarkuar me urdhër të prokurorit të çështjes, njëherësh dhe drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; (ii) ecurisë hetimore e gjyqësore të këtij procedimi penal; (iii) përbërjes së strukturës organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për vitet 2011 dhe 2012 vetëm me një drejtues, një prokuror dhe një oficer të policisë gjyqësore, subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj, përfaqëson një sjellje që tregon trajtimin me neglizhencë të situatës, e cila ndikon në perceptimin e publikut në integritetin dhe pavarësinë e organeve të drejtësisë.

26.5. Komisioni, në analizë të të dhënave të sistemit TIMS, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me dy automjete në pronësi të shtetasit A. Z., përkatësisht ka dy dalje nga pika kufitare Qafë Morinë, më datë 02.12.2013 dhe 09.02.2014, me automjetin me targë {***} dhe ka 1 dalje më datë 04.12.2013, me automjetin me targë {***}, në pronësi të këtij shtetasi dhe përdorues shtetasin A. K. nga viti 2011 – 2016. Me automjetin me targë {***}, rezulton të ketë udhëtuar (dalje më datë 07.06.2012 nga pika kufitare Qafë Morinë) dhe shtetasi P. Ç.. Lidhur me situatën e shtetasit A. Z., të paraqitur në ankimin e Komisioneres Publike, trupi gjykues konstaton se:

26.5.1. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar²⁶ dosjen penale që i përket procedimit penal nr. {***} të vitit 2007, në ngarkim të shtetasit A. Z., nga i cili rezulton se prokurori i çështjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë R. S., më datë 05.10.2007, ka nxjerrë dy urdhra, përkatësisht urdhrin e regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera”, kryer në bashkëpunim, në emër të personave nën hetim, T. T. dhe A. Z., si dhe urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Në të dy këta urdhra, prokurori i çështjes ngarkon oficerin e policisë gjyqësore Artur Ismajlukaj për kryerjen e veprimeve hetimore. Po ashtu, me urdhrin e datës 29.10.2007, “Për kthimin e sendit të sekuestruar”, prokurori ngarkon përsëri subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj.

²⁶ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 24.02.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Prokuroria përcjell dhe procedimin nr. {***} të vitit 2010, i regjistruar për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit Z. B., me kallëzues shtetasin A. Z., si dhe vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. Z.

26.5.2. Në cilësinë e OPGj-së, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore²⁷, në përfundim të të cilave, në mbështetje të nenit 327/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka përgatitur relacionin “Për përfundimin e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. {***}, viti 2007”, datë 02.11.2007, me sugjerimin që procedimi penal nr. {***} i vitit 2007, i regjistruar për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 174, 25 të Kodit Penal, me të pandehur A. Z. dhe T. T., të kalojë për gjykim.

26.5.3. Prokurori i çështjes paraqiti kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2007 dhe në diskutimet përfundimtare, kërkoi deklarinimin fajtor të të pandehurve A. Z. dhe T. T. dhe dënimin e tyre me 3 muaj burgim secili, dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi për një periudhë prej 18 muajsh. Vlera prej 32.000 lekësh, e përfituar nga shitja e mallit të sekuestruar, të kalojë në administrim të shtetit.

26.5.4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. {***}, datë 07.12.2007, vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurve A. Z. dhe T. T. për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 174 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tyre me gjobë në vlerën prej 150.000 lekësh secili dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht në vlerën 100.000 lekë. Kalimin e vlerës së mallit të sekuestruar të ngurtësuar në Bankën Raiffeisen ShA, në vlerën 32.000 lekë, në favor të shtetit. Ky vendim mori formë të prerë më datë 17.12.2007.

26.5.5. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 10.03.2023, ka informuar se shtetasi A. B. Z., deklaruar fajtor për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera”, me vendimin nr. {***}, datë 7.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

26.5.6. Gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me marrëdhënien me shtetasin A. Z. dhe qëllimin e udhëtimit me automjetet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ka pasur marrëdhënie shoqërore me të, e cila daton përpara dënimit të tij penal dhe qëllimi i udhëtimit ka qenë për të shkuar në Tiranë ku kishte banimin dhe anasjelltas, pasi mundësitë për të lëvizur në orare të ndryshme kanë qenë të kufizuara. Linjat e udhëtimit kanë pasur orare fikse, në orët e mëngjesit dhe pas orës 12:00 ishte e pamundur lëvizja në drejtim të Tiranës dhe anasjelltas. Subjekti i rivlerësimit në vijim shprehet se fakti që i pandehuri është dënuar nga gjykata për një vepër penale për të cilën veprimet dhe procedurat hetimore janë realizuar nga subjekti i rivlerësimit, vërteton se ky i fundit nuk është ndikuar në kryerjen e detyrës nga marrëdhëniet e njohjes me këtë shtetas. Dënimi i tij me gjobë nga gjykata, provon edhe rëndësinë e veprës penale në raport me shkeljen e ligjit. Pas marrjes së këtij dënimi, shtetasi A. Z. ka ushtruar funksione të ndryshme në administratën publike të qytetit të Bajram Currit, pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë, Bashkisë Tropojë dhe Postës Shqiptare, filiali Kukës, fakt që

²⁷ Procesverbal “Për pyetjen e të pandehurit”, datë 29.10.2007; procesverbal “Për dorëzimin e provës materiale të përfituar nga shitja”, datë 09.10.2007; procesverbal “Për shitjen e provës materiale”, datë 09.10.2007, që kanë të bëjnë me 2000 kg gështenja; procesverbal “Për lënien në ruajtje në bankë të vlerës monetare të sekuestruar”, datë 01.11.2007; procesverbal “I shpenzimeve procedurale për procedimin penal nr. {***} të vitit 2007”; procesverbal “Për njohjen e të pandehurit me materialet e çështjes”, datë 30.10.2007 (për secilin të pandehur); procesverbale të datës 29.10.2007, “Për kthimin e sendit të sekuestruar” (për secilin të pandehur).

provohet nga aktet shkresore²⁸ të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të cilat, sipas tij, vërtetojnë edhe rehabilitimin shoqëror, përveçse atij penal, të këtij shtetasi.

26.5.7. Në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, kryerja e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, si oficer i policisë gjyqësore, në kuadër të procedimit penal nr. 101 të vitit 2007, ndaj shtetasit A. Z., pavarësisht ecurisë hetimore e gjyqësore të këtij procedimi, në kushtet e marrëdhënieve shoqërore me të, si dhe udhëtimi me automjetet në pronësi të tij në datat 02.12.2013, 04.12.2013 dhe 09.02.2014, përfaqësojnë një sjellje të pakujdesshme që ndikon në perceptimin e publikut rreth integritetit dhe pavarësisë së organeve të drejtësisë.

26.5.8. Me automjetin me targë {***}, në pronësi të shtetasit A. Z., i cili nga të dhënat e gjeneruara nga “Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, rezulton se është i markës “Mercedes Benz”, modeli “Sprinter” me 3 vende, ka udhëtuar më datë 07.06.2012, dhe shtetasi P. Ç., i cili sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. {***} prot., datë 27.06.2023, rezulton të jetë dënuar për disa vepra penale²⁹ gjatë periudhës 2006 – 2018 nga gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Lezhë, Durrës e Tropojë. Komisioni, në vendim, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë udhëtuar me këtë shtetas, i cili është dënuar për disa vepra penale, por jo për ato të parashikuara në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për ta klasifikuar si person të përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë rast, Komisionerja Publike, përveç konstatimeve, nuk ka parashtruar ndonjë problematikë.

26.6. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit standard ka deklaruar se ka përdorur automjetin me targë {***}, në pronësi të shtetasit S. K., pa prokurë apo pa akt të veçantë, për arsye personale, pa shpërblim dhe për një periudhë të shkurtër kohore në vitin 2016, pasi në këtë periudhë nuk kishte mjet në pronësi apo përdorim dhe i duhej një i

²⁸ (i) Urdhër nr. {***}, datë 14.08.2018, i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë “Për emërimin e z. A. Z. specialist i marrëdhënieve me publikun”; (ii) urdhër nr. {***}, datë 11.11.2019, “Për ushtrimin e kompetencave të drejtorit të drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë”; (iii) urdhër nr. {***}, datë 15.11.2018, të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Tropojë “Për emërimin definitiv të z. A. Z., specialist i marrëdhënieve me publikun”; (iv) vendim nr. {***}, datë 07.12.2020, i Bashkisë Tropojë për emërimin e z. A. Z. në pozicionin e Drejtorit të Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit; (v) urdhër nr. {***}, datë 07.12.2020, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tropojë “Për shkëputjen e marrëdhënieve të punës të punonjësit A. Z.”; (vi) vendim nr. {***}, datë 08.10.2021, i Bashkisë Tropojë për miratimin e dorëheqjes dhe ndërprerjen e marrëdhënies juridike të punës me Bashkinë Tropojë të z. A. Z.; (vii) shkresë nr. {***} prot., datë 20.07.2022, e Postës Shqiptare ShA, me lëndë: “Emërim në detyrë në vendin e punës “Kryetar dege”, në degën e Postës Bajram Curri, pranë Filialit të Postës Kukës, i z. A. Z., deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të çështjes së z. A. Q.”; (viii) urdhër nr. {***}, datë 20.07.2022, me të njëjtën lëndë; (ix) urdhër nr. {***}, datë 20.07.2022, i Postës Shqiptare ShA, filiali Kukës, për emërimin në detyrën Kryetar Dege të z. A. Z.

²⁹ Veprat penale të (1) “Mashtimit” në bazë të nenit 143 të Kodit Penal; (2) “Largimit të të dënuarit nga vendi i vuajtjes së dënimit, e në bazë të nenit 323/1 të Kodit Penal; (3) “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt” e në bazë të nenit 291, 48/ç të Kodit Penal; (4) “Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal; (5) “Vjedhjes”, “Përvetësim të titullit apo detyrës shtetërore”, bazuar në nenet 134/1, 246/2, 55 të Kodit Penal; (6) “Vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

tillë për lëvizje. Në përgjigjet e pyetësorit të dytë, datë 18.11.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me shtetasit A. K.³⁰ dhe S. K. ka lidhje familjare.

26.6.1. Referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 21.03.2023, automjeti me targë {***}, është blerë nga S. K. më datë 14.03.2016, në Francë, në vlerën 1.500 euro. Në dokumentin “Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, është regjistruar si përdorues dhe subjekti i rivlerësimit Artur Ismajlukaj për periudhën prill 2016 – prill 2018. Më datë 27.10.2017, ky automjet rezulton të jetë shitur nga S. K. tek E. K., e më pas është tjetërsuar në persona të tjerë.

26.6.2. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni administroi shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila përcjell vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit S. K., i cili në bazë të vendimit nr. {***}, datë 01.02.1992, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale “Vjedhje e pasurisë shtetërore”, dënuar me 6 muaj heqje lirie dhe rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

26.6.3. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se me shtetasin S. K. ka njohje dhe lidhje familjare. Konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dijeni për vendimin e dënimit të vitit 1992, kohë në të cilën nuk jetonte në Tropojë dhe ishte në moshën 13-vjeçare, nuk është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka pasur kontakte me këtë shtetas në një kohë shumë të mëvonshme se vendimi i dënimit të tij, e për më tepër në një periudhë në të cilën ky shtetas rezulton i rehabilituar.

26.6.4. Nga të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar se me automjetin me targë {***}, më datë 28.09.2016, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar dhe me shtetasin N. L. (dalë nga pika kufitare e Qafë Morinës). Ky shtetas, referuar vërtetimit të gjendjes gjyqësore³¹, rezulton i deklaruar fajtor dhe i dënuar me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 89 dhe 25 i Kodit Penal dhe me vendimin nr. {***}, datë 28.07.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për veprën penale të “Goditjes për shkak të detyrës”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 237 e 25 të Kodit Penal dhe rehabilitohet në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë, datë 11.04.2022.

26.6.5. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, në lidhje me shtetasin N. L., subjekti i rivlerësimit shprehet se e njeh për shkak të lidhjes familjare që ky i fundit ka me shtetasin S. K. Me shtetasin N. L., subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka pasur kontakte të mëparshme apo të mëpasshme, me përjashtim të kontaktit rastësor të datës 28.09.2016. Ky udhëtim, sipas subjektit të rivlerësimit, është kryer për nevoja personale të tij dhe për shkak të përdorimit të automjetit të shtetasit S. K., është marrë shtetasi N. L. në cilësinë e drejtuesit (shoferit) të

³⁰ Shtetasi A. K., me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është deklaruar i pafajshëm për veprën penale “Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës”, parashikuar nga neni 170/b i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 22.01.2020, ka vendosur mospranimin e ankimit prokurorit; me vendimin penal nr. {***}, datë 26.01.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka vendosur pushimin e gjykimit ndaj tij, i akuzuar për veprën penale “Fyerje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 239 i Kodit Penal.

³¹ Përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2023.

automjetit.

26.6.6. Trupi gjykues vlerëson se përdorimi në vitin 2016 nga subjekti i rivlerësimit i automjetit në pronësi të shtetasit S. K., që referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton i deklaruar fajtor dhe i dënuar me vendimin nr. {***}, datë 01.02.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Vjedhje e pasurisë shtetërore”, e me të cilin deklaroi të ketë njohje dhe lidhje familjare, ashtu edhe udhëtimi i subjektit të rivlerësimit më datë 28.09.2016 me këtë automjet, me shtetasin N. L., i cili rezultoi të jetë deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2007, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, dhe me vendimin nr. {***}, datë 28.07.2008, për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, kryer në bashkëpunim, tregojnë sjellje që mund të afektojnë integritetin dhe etikën profesionale të prokurorit.

27. Komisionerja Publike përmend disa rrethana, të cilat paraqesin elemente që mund të merren në konsideratë në gjykimin e kësaj çështjeje, në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të tilla si: (i) mospërputhja e deklarimeve lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 96,2 m², dhe përfshirja në deklaratën e pasurisë si burim krijimi dhe shuma prej 1.000.000 lekësh, dhuratë nga vjehri A. P.; (ii) shuma transferohet te G. S. M., i cili rezultoi i rehabilituar pasi me vendimin nr. {***}, datë 31.03.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është deklaruar fajtor për veprat penale “Përvetësim i pasurisë shtetërore në bashkëpunim” dhe “Armbajtje pa leje”. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se:

27.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi, për herë të parë si burim për porositjen e apartamentit³² në vlerën 36.000 euro, ndodhur në rr. “{***}”, Njësia Administrative Dajt, edhe shumën prej 1.000.000 lekësh, dhuruar nga vjehri A. P., ndërkohë që nuk e deklaroi atë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014.

27.2. Komisioni, në vendim, ka konkluduar se vjehri ka disponuar burime të mjaftueshme financiare për investimet e tij dhe dhënien e dhurimit në përputhje me nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit edhe nëse ky dhurim nuk do të konsiderohej. Pasaktësinë në plotësimin e deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2014, e saktësuar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, si një mundësi që ky ligj u dha subjekteve të rivlerësimit për të saktësuar deklaratimet e tyre në vite, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë burimesh financiare, Komisioni e ka vlerësuar pa peshë në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me vërtetësi pasurinë apartament, të ndodhur në një zonë periferike të Tiranës, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e saj.

27.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 05.02.2016, të vjehrit A. P., i cili deklaroi se në maj të vitit 2011, ai ka derdhur në llogarinë e dhëndrit Artur Ismajlukaj, shumën prej 1.000.000 lekësh

³² Apartamenti është porositur nga subjekti i rivlerësimit pranë shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK me kontratë porosie nr. {***} rep./kol., datë 23.04.2011, në vlerën 36.000 euro. Përfshirë në procedura legalizimi, për të cilin është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 23.09.2020, nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

nëpërmjet Raiffeisen Bank ShA, të cilën ia ka dhuruar për blerjen e një apartamenti të përbashkët me vajzën e tij. Nga informacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 07.04.2021, rezulton se në llogarinë rrjedhëse të pagës së subjektit të rivlerësimit, është derdhur më datë 17.05.2011 në *cash*, shuma 1.000.000 lekë nga A. P.. Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit e transferon këtë shumë në llogarinë bankare të shtetasit G. S. M..

27.4. Lidhur me këtë shtetas, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve³³ informoi Komisionin se G. S. M. rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, pasi me vendimin nr. {***}, datë 31.03.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka qenë i deklaruar fajtor për veprat penale të “Përvetësimit të pasurisë shtetërore”, në bashkëpunim dhe “Armëmbajtjes pa leje”, dhe është dënuar me dy vjet heqje lirie.

27.5. Sa i përket transferimit të shumës prej 1.000.000 lekësh te G. M., subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit të dytë, ka sqaruar se në kushtet kur punonte në Tropojë, shumën e ka kaluar në llogarinë e këtij shtetasi për arsye që ta këmbente në monedhën euro dhe të kishte mundësi që kur të vinte në Tiranë, të përdorte shumën e këmbyer në monedhën euro, me qëllim kryerjen e pagesave të apartamentit. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se veprimi i transferimit të vlerës prej 1.000.000 lekësh, është kryer në vitin 2011 dhe përkon me veprimet financiare të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e detyrimeve për fitimin e pronësisë së apartamentit të banimit.

27.6. Në vlerësim të trupit gjykues, transferimi i shumës prej 1.000.000 lekësh, dhuruar nga vjehri, i deklaruar si burim krijimi për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2011 në deklaratën e pasurisë *vetting*, te shtetasi G. M. me të cilin ka lidhje familjare, pavarësisht nga arsyeja e dhënë, ndërkohë që ky shtetas rezulton të jetë deklaruar fajtor me vendimin nr. {***}, datë 31.03.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për veprat penale “Përvetësim të pasurisë shtetërore” në bashkëpunim, si dhe “Armëmbajtje pa leje”, duhej të shmangej nga subjekti i rivlerësimit në funksion të ruajtjes së figurës së funksionarit të organeve të drejtësisë, ndërsa konsiderohet pa peshë pasaktësia në deklaratën periodike 2014 lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament.

28. Në vlerësim të trupit gjykues, rrethanat faktike të konstatuara, si mungesa e kujdesit për të qenë i informuar mbi situatat në të cilat vendoste veten, përfshirë automjetet me të cilat udhëtonte apo kryerja e veprimeve hetimore ndaj personave me të cilët ka pasur marrëdhënie shoqërore, tregojnë elemente që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, hedhin dyshime mbi integritetin dhe etikën profesionale të subjektit të rivlerësimit, si dhe mund të ndikojnë në perceptimin e publikut në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë, duke afektuar kështu besimin në to.
29. Sjellja e magjistratit jashtë ushtrimit të funksionit, ka marrë rëndësinë e një vlere themelore dhe gjen trajtim në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit *sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*. Jashtë ushtrimit të funksioneve të tij, magjistrati nuk duhet të ketë sjellje që cenojnë besueshmërinë personale, dinjitetin e tij apo prestigjin e institucionit gjyqësor, pasi përbën

³³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2023.

shkelje çdo sjellje që cenon pavarësinë, paanshmërinë, qoftë edhe në aspektin e pamjes. Nëse do t'i drejtoheshim për paralelizëm Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, paragrafi 143 i tij, përmend detyrimin e gjyqtarit për të shmangur ndikimin e papërshtatshëm, duke treguar kujdes të veçantë për t'u siguruar që sjellja apo gjykimi as në subkoshiençën e tij nuk është ndikuar nga marrëdhënie të familjarëve, miqve apo kolegëve të tij.

Për rastin në fjalë, për pretendimin e Komisioneres Publike, se në këto rrethana përfshihen si problematika jo vetëm udhëtimet e përsëritura me automjetet e personave me probleme me drejtësinë, por dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi normalitetin e kësaj situatë, sipas të cilit, *për shkak të lidhjeve familjare dhe shoqërore, jetesës për një kohë të gjatë në të njëjtin komunitet, është më se e rëndomtë që të krijohen kontakte të rastësishme me persona të vlerësuar nga Komisioni si të papërshtatshëm*, trupi gjykues, përpos qëndrimit të mbajtur më sipër në këtë vendim, gjen me vend të theksojë dhe përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të evituar këto situata. Konkretisht, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si oficer i policisë gjyqësore dhe përpara nisjes së reformës në drejtësi, i është drejtuar dy herë Prokurorit të Përgjithshëm me kërkesë për transferim³⁴, në të cilat, përveç largësisë nga familja, ngre si shqetësim dhe faktin se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë në një rreth të vogël si Tropoja dhe duke qenë i vetëm në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, është konsumuar si profesionalisht, edhe nga ana sociale, pasi për shkak të lidhjeve farefisnore dhe shoqërore, në shumë raste ka qenë i detyruar nga rrethanat të kërkojë zëvendësimin në hetimin e procedimeve penale, gjë e cila, sipas tij, ka vështirësuar mbarëvajtjen e punës në këtë prokurori. Këto shqetësime, subjekti i rivlerësimit i ka përsëritur dhe në kërkesën për transferim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë më datë 20.01.2021, tanimë në funksionin e prokurorit. Kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit tregon se ai ka qenë i ndërgjegjshëm për rrethanat specifike në të cilat ka ushtruar veprimtarinë e tij si oficer i policisë gjyqësore dhe ka ndërmarrë iniciativa konkrete për të shmangur vazhdimin e përmbushjes së detyrës në kushtet që mund ta ekspozonin në situata të mundshme të konfliktit të interesit, apo mund të ndikonin në një perceptim negativ të publikut ndaj funksionarit të drejtësisë.

30. Në rastin objekt shqyrtimi, pavarësisht se u evidentuan fakte, ngjarje e të dhëna që meritojnë të analizohen në kuadër të vlerësimit tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, i udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, i ndodhur përpara elementeve të tilla, si: (i) një pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e oficerit të policisë gjyqësore; (ii) disa nga personat kanë qenë të rehabilituar në kohën e kryerjes së veprimit të caktuar nga subjekti i rivlerësimit, si përdorimi i automjetit apo transferimi bankar i shumës; (iii) mbi të gjitha nuk u evidentua që ushtrimi i funksionit të subjektit të rivlerësimit të jetë ndikuar nga kontakti me këta persona apo ngjarje, si dhe në kushtet kur dispozitat kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit nuk parashikojnë masa të tjera disiplinore më të lehta se ajo e shkarkimit nga detyra, situatat e analizuar më sipër u gjetën të pamjaftueshme nga trupi gjykues për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

³⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.06.2023, Prokuroria e Përgjithshme dërgon dy kërkesa për transferim, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.10.2011 dhe datë 31.01.2014, gjatë periudhës kur ka qenë oficer i policisë gjyqësore

31. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisionerja Publike, nuk u gjetën të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit, i cili për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 02.04.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, në përfundim, pas shqyrtimit të çështjes, kam propozuar për ndryshimin e vendimit nr. 681, datë 07.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj.
2. Konkluzioni i arritur nga shumica e trupit gjykues se: *[...] situatat e analizuara u gjetën të pamjaftueshme nga trupi gjykues për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë [...], vlerësoj se nuk është proporcional lidhur me analizën e fakteve të përgjithshme të kësaj çështjeje, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Artur Ismajlukaj. Më konkretisht:
 - 2.1. *[...] kalimi i kufirit shqiptar në pikën kufitare Qafë Morinë, me automjetin në pronësi të shtetasit K. J., person i përfshirë në krimin e organizuar, [...] nuk e kualifikojnë subjektin, si të papërshtatshëm në kuptim të kriterit të figurës, por nuk e përjashtojnë atë nga përgjegjësia për pakujdesinë e treguar në udhëtimin me këtë automjet [...].*
 - 2.2. *[...] kryerja e veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të procedimit penal, në ngarkim të shtetasit D. M., ndërkohë që ka pasur marrëdhënie shoqërore me vëllain e tij B. M., [...] përfaqëson një sjellje që tregon trajtimin me neglizhencë të situatës, e cila ndikon në perceptimin e publikut në integritetin dhe pavarësinë e organeve të drejtësisë.*
 - 2.3. *[...] kryerja e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndaj shtetasit A. Z., pavarësisht ecurisë hetimore e gjyqësore të këtij procedimi, në kushtet e marrëdhënieve shoqërore me të, si dhe udhëtimi disa herë, me automjetet në pronësi të tij, përfaqësojnë një sjellje të pakujdesshme që ndikon në perceptimin e publikut rreth integritetit dhe pavarësisë së organeve të drejtësisë.*
 - 2.4. *[...] përdorimi nga subjekti i rivlerësimit i automjetit në pronësi të shtetasit S. K., [...] i deklaruar fajtor dhe i dënuar për veprën penale “Vjedhje e pasurisë shtetërore”, e me të cilin deklaroi të ketë njohje dhe lidhje familjare, ashtu edhe udhëtimi i subjektit të rivlerësimit me këtë automjet, me shtetasin N. L., i cili rezulton të jetë deklaruar fajtor për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, dhe për veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”, kryer në bashkëpunim, tregojnë sjellje që mund të afektojnë integritetin dhe etikën profesionale të prokurorit.*
 - 2.5. *[...] transferimi i shumës prej 1.000.000 lekësh [...] te shtetasi G. M., me të cilin ka lidhje familjare, pavarësisht nga arsyeja e dhënë, ndërkohë që ky shtetas rezulton të jetë deklaruar fajtor për veprat penale “Përvetësim të pasurisë shtetërore” në bashkëpunim, si dhe “Armbajtje pa leje”, duhej të shmangej nga subjekti i rivlerësimit në funksion të ruajtjes së figurës së prokurorit [...].**
3. Në vlerësim tim si gjyqtare në pakicë, sjelljet e subjektit si më sipër, nuk mund të justifikohen me pretendimet e parashtruara, që lidhen me: largësinë nga familja, lidhjet farefisnore dhe shoqërore në një rreth të vogël si Tropoja etj. Për vetë funksionin e tij, subjekti i rivlerësimit duhet të mbante një distancë të sigurt nga personat me probleme me drejtësinë, për të ruajtur integritetin e tij si prokuror, të sistemit të drejtësisë në tërësi, për të shmangur çdo ndikim të

mundshëm apo përceptim negativ të publikut mbi të, sidomos kur bëhet fjalë për një rreth të vogël, siç është Tropoja. Kryerja e veprimeve hetimore ndaj personave me të cilët ka pasur marrëdhënie shoqërore, si dhe udhëtimet e përsëritura me automjetet në pronësi të personave me probleme me drejtësinë, në vlerësimin tim, hedhin dyshime mbi integritetin dhe etikën profesionale të një funksionari të sistemit të drejtësisë, elemente të mjaftueshme këto, që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes për prokurorin.

4. Konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se: [...] pavarësisht se u evidentuan fakte, ngjarje e të dhëna që meritojnë të analizohen në kuadër të vlerësimit tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, i udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, i ndodhur përpara elementeve të tilla, si: (i) një pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e oficerit të policisë gjyqësore; (ii) disa nga personat kanë qenë të rehabilituar në kohën e kryerjes së veprimit të caktuar nga subjekti i rivlerësimit, si përdorimi i automjetit apo transferimi bankar i shumës; (iii) mbi të gjitha nuk u evidentua që ushtrimi i funksionit të subjektit të rivlerësimit të jetë ndikuar nga kontakti me këta persona apo ngjarje, si dhe në kushtet kur dispozitat kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit nuk parashikojnë masa të tjera disiplinore më të lehta se ajo e shkarkimit nga detyra, situatat e analizuara më sipër u gjetën të pamjaftueshme nga trupi gjykues për të bërë të zbatueshëm nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë[...] – e vlerësoj të padrejtë, pasi edhe vetë shumica i ka konsideruar sjelljet e subjektit si mungesë kujdesi, dyshime mbi integritetin dhe etikën profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të ndikojnë në perceptimin e publikut në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë, duke afektuar kështu besimin në to (shih paragrafin 28 të vendimit).
5. Unë, si gjyqtare në pakicë, çmoj se rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, mbi të cilin është ushtruar ankimi i Institucionit të Komisionerëve Publikë, duhet pranuar. Në vlerësimin tim, për këtë çështje nuk mund të zbatohet parimi i proporcionalitetit apo objektivitetit, pasi rastet e sjelljes që hedhin dyshime mbi integritetin dhe etikën profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë të përsëritura, gjatë gjithë karrierës së tij, pavarësisht detyrës së ushtruar, oficer i policisë gjyqësore apo prokuror, sjellje të cilat në dukje japin panoramën e një familjariteti të subjektit të rivlerësimit me persona që kanë probleme me drejtësinë. Mbi këtë arsyetim, kam votuar kundër vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi